



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

Nr. 2078 / Prot
1

Tiranë, më 01/10 /2020

Lënda: Njoftim për shpallje të lëvizjes paralele

SHKOLLËS SË MESME PROFESIONALE _____

DREJTORISË RAJONALE TË FORMIMIT PROFESIONAL PUBLIK _____

Në zbatim të Ligjit Nr.15/2019 “Për nxitjen e Punësimit”, Ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit të Këshilli të Ministrave nr.554, datë 31.07.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”, Udhëzimit nr.11, datë 3.3.2020 “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional”, Urdhërit nr.172, datë 24.12.2019 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive” dhe shkresës nr.691/1 prot, datë 24.08.2020 “Njoftim për vende të lira pune (mundësi për lëvizje paralele)” të Shkollës së Mesme Profesionale “Kolin Gjoka” Lezhë, protokolluar në AKPA me nr.2078 prot, datë 26.08.2020,

Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive ju njofton shpalljen e procedurave të **lëvizjes paralele** për personelin mësimdhënës të teorisë profesionale, në Shkollën e Mesme Profesionale “Kolin Gjoka” Lezhë, për pozicionet:

- a) 3 Mësimdhënës të teorisë profesionale, drejtimi Hoteleri-Turizëm, me kohë të plotë
- b) 2 Mësimdhënës të teorisë profesionale, drejtimi TIK, me kohë të plotë
- c) 1 Mësimdhënës të teorisë profesionale, drejtimi Shërbime Sociale e Shëndetësore, me kohë të plotë
- d) 1 Mësimdhënës të teorisë profesionale, drejtimi Teknologji Ushqimore, me kohë të plotë

1. Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme për personelin mësimdhënës të teorisë profesionale në Shkollën e Mesme Profesionale “Kolin Gjoka” Lezhë

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme për lëvizjen paralele si vijon:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;

- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe motivimit.

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme për personelin mësimdhënës të teorisë profesionale në Shkollën e Mesme Profesionale “Kolin Gjoka” Lezhë si vijon:

- a) të ketë diplomë nga një institucion i arsimit të lartët të nivelit master i profesionit ose master i shkencave ose të barasvlershme, për një nga profilet që lidhet me zhvillimin e kurrikulës së kulturës profesionale të ofruesit të AFP-së;
- b) të ketë të paktën 3 (tre) vjet eksperiencë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet;
- c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit

2.Vendi dhe afati i dorëzimit të dokumentave

Aplikantët duhet të dorëzojnë kërkesën për lëvizje paralele dhe dokumentacionin përkatës pranë Shkollës së Mesme Profesionale “Kolin Gjoka” Lezhë, brenda 5 ditëve nga njoftimi. Afati i njoftimit fillon më datë 02.09.2020.

Nëse nuk paraqiten kërkesa për lëvizje paralele brenda afatit të mësipërm, Shkolla e Mesme Profesionale “Kolin Gjoka” Lezhë, të fillojë procedurën për shpalljen e vendit të lirë, për pozicionet:

- a) 3 Mësimdhënës të teorisë profesionale, drejtimi Hoteleri-Turizëm, me kohë të plotë
 - b) 2 Mësimdhënës të teorisë profesionale, drejtimi TIK, me kohë të plotë
 - c) 1 Mësimdhënës të teorisë profesionale, drejtimi Shërbime Sociale e Shëndetësore, me kohë të plotë
 - d) 1 Mësimdhënës të teorisë profesionale, drejtimi Teknologji Ushqimore, me kohë të plotë
- në zbatim të Udhëzimit nr. 11, datë 3.3.2020 “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional”.

Shkolla e Mesme Profesionale “Kolin Gjoka” Lezhë brenda 5 ditëve pune pasi është mbyllur procedura e lëvizjes paralele dhe nuk është paraqitur asnjë kërkesë për lëvizje paralele, shpall njoftimin për vendin e lirë në faqen zyrtare të AKPA-s, në faqen elektronike zyrtare të Shkollës së Mesme Profesionale “Kolin Gjoka” Lezhë, si dhe në një vend të dukshëm në hyrje të Shkollës së Mesme Profesionale “Kolin Gjoka” Lezhë.

